

UDHËZIM
Nr. 2, datë 17.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 11.2.2010 “MBI KONTROLLIN TEKNIK TË MJETEVE RRUGORE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1. Në nenin 1, pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Drejtuesit e mjeteve rrugore duhet të dorëzojnë te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor KTV kontratën e sigurimit të mjetit. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet.”.
 2. Në nenin 5, në fund të pikës 4 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:
“Në certifikatën e kontrollit teknik do të shënohet numri i serisë së kontratës së sigurimit të mjetit dhe emri i kompanisë që e ka lëshuar.”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**